



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 64.5 pika (b) të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe Rregullores së Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, neni 17, pika d), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datën 21.12.2015, nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2015
PËR SHFRYTËZIMIN E TELEFONISË NË KOMISIONIN QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

I. DISPOZITATE PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

- 1.1. Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin e procedurave për shfrytëzimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe mobile për anëtarët e Komisionit dhe zyrtarët e Sekretariatit (në tekstin e mëtejme: shfrytëzuesit), si dhe procedurat për ndarjen dhe shfrytëzimin e telefonave të linjës fikse, ndarjen dhe shfrytëzimin e telefonave mobilë dhe SIM kartelës, si dhe shumë e lejuar me qëllim të kryerjes së punëve dhe detyrave në kuadër të përgjegjësive të tyre.
- 1.2. Ky Udhëzim Administrativ përcakton shfrytëzimin efikas të telefonave fiks dhe mobilë, si dhe rregullon përgjegjësitë individuale dhe kolektive përkitazi me shfrytëzimin zyrtar të telefonave fiks dhe mobilë.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të detyrueshme për të gjithë shfrytëzuesit brenda Komisionit.

Neni 3

E drejta në telefon mobil zyrtar të Komisionit dhe e SIM kartelave

1. Telefoni mobil, SIM kartela dhe mbulimi i shpenzimeve, jepen për qëllimin e vetëm, që shfrytëzuesve t'iu mundësohet kryerja e detyrave të tyre zyrtare.
2. Të drejtën për telefon mobil e kanë anëtarët e Komisionit.
3. Të drejtën për telefon mobil e kanë Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit, zëvendësi i KE-së, drejtori i ZRPPC-së, drejtorët e departamenteve dhe në raste të caktuara zyrtarët tjerë, sipas vlerësimit të KE-së.
4. Të drejtën në SIM kartela dhe mbulim të shpenzimeve të telefonisë mobile, e kanë: anëtarët e Komisionit dhe stafi i Sekretariatit.

Neni 4

Shfrytëzimi i telefonave mobilë zyrtarë dhe i SIM kartelave

1. Departamenti i Administratës dhe i Përkrahjes i Sekretariatit u dorëzon shfrytëzuesve telefonat mobilë dhe SIM kartelat, dhe bën mbulimin e shpenzimeve. Këto nuk mund t'u barten shfrytëzuesve tjerë.
2. Shfrytëzuesit të cilët marrin telefona mobilë dhe SIM kartela mbushëse, e nënshkruajnë dokumentin e pranimit, në të cilin shënohen: numri serik i telefonit mobil dhe vlera e SIM kartelës mbushëse. Shfrytëzuesi, përmes nënshkrimit të vet, e pranon përgjegjësinë e plotë për telefonin mobil dhe SIM kartelën mbushëse që ka marrë. Ai do të jetë përgjegjës në rast të humbjes të telefonit mobil ose të dëmtimit.
3. Për kthimin ose jo të aparatit të telefonisë mobile dhe SIM kartelës, pas përfundimit të marrëdhënies se punës, do të vendoset: për anëtarët e Komisionit, me vendim të Komisionit, ndërsa për stafin e Sekretariatit, me vendim të KE-së.
4. Departamenti i Administratës dhe i Përkrahjes i Sekretariatit, do ta mbajë një evidencë me emrat e shfrytëzuesve të cilëve u janë dhënë aparatet e telefonisë mobile dhe SIM kartelat.

Neni 5

Edrejta e shfrytëzimit të linjës fikse

5. Të drejtën në telefoninë fikse e kanë anëtarët Komisionit dhe i gjithë stafi i Sekretariatit.
6. Kryetari i Komisionit dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit, kanë qasje të pakufizuar, duke përfshirë qasje ndërkombëtare nga linja e tyre fikse.
7. Anëtarët e Komisionit kanë qasje nga linja e tyre fikse edhe në telefoninë mobile.

8. Drejtori i ZRPPC-së, drejtorët e departamenteve të Sekretariatit, zëdhënësi i Komisionit, asistentja e Kryetarit të Komisionit dhe Asistentja e KE-së së Sekretariatit, kanë qasje nga linja fikse edhe në telefoninë mobile.
9. Stafit tjetër i Sekretariatit ka qasje nga linja e tyre fikse në linjat centrix dhe fikse.
10. Me qëllim të përmbushjes së operacioneve zgjedhore, me vendim të KE-së mund të lejohet qasje e re dhe e përkohshme ndërkombëtare brenda Sekretariatit.

Neni 6 Instalimi dhe mirëmbajtja

1. Departamenti për Teknologji Informative ("DTI") në Komision, është përgjegjës për mirëmbajtjen e rrjetit të telefonisë fikse.
2. Çdo zyrtar që ka nevojë zyrtare për linjë të telefonisë fikse, duhet të plotësojë formularin për pajisje me telefon dhe linjë telefonike, të kërkojë aprovimin nga mbikëqyrësi dhe duhet të dorëzojë kërkesën për miratim të Kryeshefi Ekzekutiv.
3. Në rast të paraqitjes së problemit të mosfunksionimit të telefonisë fikse, zyrtari përkatës duhet ta lajmërojë DTI-në.

Neni 7 Shpenzimet mujore për telefoninë fikse dhe telefoninë mobile

1. Niveli i qasjes dhe lartësia e lejuar e shpenzimeve mujore për linjat fikse për të gjithë të punësuarit në Komision, është paraqitur në tabelën, si: Shtojca I e këtij Udhëzimi.
2. Lartësia e lejuar e shpenzimeve mujore për shërbimin e telefonisë mobile për të gjithë të punësuarit në Komision, është paraqitur në tabelën, si: Shtojca II e këtij Udhëzimi.
3. Të gjithë të punësuarit në Komision, sa herë ka mundësi, duhet të përfshihen në pakon e përbashkët ku do të mund të komunikojnë pa pagesë.

Neni 8 Përgjegjësia për shfrytëzimin e telefonit zyrtar

4. Të gjithë shfrytëzuesit e telefonisë fikse në Komision, ku ekziston mundësia e komunikimit me CENTREX dhe FIX, janë të obliguar të përdorin këta numra gjatë komunikimit me të gjitha institucionet dhe palët e përfshira në këtë sistem.
5. Shpenzimet e paarsyetuara, e që tejkalojnë shumat e përcaktuar me udhëzim, kompensohen nga vet zyrtari për shumën e tejkualuar.

Neni 9
Mbikëqyrja e shpenzimeve

Në bazë të raporteve të pranuara, Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes, mbikëqyrë shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile për çdo muaj dhe raporton tejkalimin eventual të tyre, të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ, te Kryeshefit Ekzekutiv, më së largu deri me datën 15 të muajit vijues.

Neni 10
Shpenzimet shtesë për nga natyra dhe lloji i punës

6. Në periudhat zgjedhore, ku paraqitet nevoja e shpenzimeve shtesë, të cilat për nga natyra dhe lloji i punës, e që kalojnë shumë mënjore të përcaktuar me këtë udhëzim administrativ, duhet miratim i veçantë nga Komisioni.
7. Në raste të veçanta, kur tejkalohen lartësia e shumave të përcaktuara me këtë udhëzim, për nevoja të kryerjes së detyrave zyrtare, zyrtarët mund të paraqesin kërkesë për mbulimin e shpenzimeve të tejkaluara.
8. Kërkesa e arsyetuar me shkrim nga paragrafi 10.2, pas vlerësimit nga mbikëqyrësi, përcillet për miratim tek Drejtori i Departamentit përkatës, tek Kryeshefi Ekzekutiv.

Neni 11
Akumulimi i shpenzimeve të telefonisë fikse

Shumat e shpenzimeve të telefonisë fikse nuk mund të barten në muajin vijues.

Neni 12
Planifikimi i shpenzimeve të telefonit

Shpenzimet e telefonit duhet të planifikohen në buxhetin vjetor Komisionit.

II. DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

Neni 13
Ndryshimet

Komisioni mund ta ndryshojë dhe plotësojë këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 14
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 03/2010 "Mbi shfrytëzimin e linjës fikse dhe telefonave mobilë zyrtarë, dhe SIM kartelës nga anëtarët e Komisionit dhe zyrtarët e Sekretariatit", e datës 25. 06. 2009.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, më 21.12.2015

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka



Shtojca I- Lartësia e lejuar e shpenzimeve të telefonisë fikse

Nr.	PËRSHKRIMI I POZITAVE	NIVELI I QASJES	SHUMA
1	Kryetar i KQZ-së	Centrix, fiks, mobil, ndërkombëtare	Pa kufizim
2	Anëtar i KQZ-së	Centrix, fiks, mobil	Pa kufizim
3	Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së	Centrix, fiks, mobil, ndërkombëtare	Pa kufizim
4	Zëvendës Kryeshef i SKQZ-së	Centrix, fiks, mobil	40
5	Drejtor i ZRPPC	Centrix, fiks, mobil	40
6	Drejtor i Auditimit	Centrix, fiks, mobil	30
7	Drejtor i DAP-it	Centrix, fiks, mobil	30
8	Drejtor i DOZ-it	Centrix, fiks, mobil	30
9	Drejtor i Prokurimit	Centrix, fiks, mobil	30
10	Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore	Centrix, fiks, mobil	30
11	Drejtor i Departamentit për Teknologji Informative	Centrix, fiks, mobil	30
12	Zëdhënës i KQZ-së	Centrix, fiks, mobil	20
13	Koordinator i ZLKZ-ve	Centrix, fiks, mobil	10
14	Koordinator i QNR-së	Centrix, fiks, mobil	10
15	Udhëheqës i Divizionit për Logjistik dhe Transport	Centrix, fiks, mobil	10
16	Koordinator i Trajnimit	Centrix, fiks, mobil	10
17	Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa	Centrix, fiks, mobil	10
18	Udhëheqës i Divizionit për Personel dhe Shërbime të Përbashkëta	Centrix, fiks, mobil	10
19	Udhëheqës i Divizionit për Informim dhe Komunikim me Publikun	Centrix, fiks, mobil	10
20	Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin Votues	Centrix, fiks, mobil	10
21	Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve	Centrix, fiks	5
22	Zyrtar i Lartë për Komunikim me Mediat dhe Publikun	Centrix, fiks	5
23	Zyrtar i Lartë Certifikues	Centrix, fiks	5
24	Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa	Centrix, fiks	5
25	Zyrtar i Lartë për Financa	Centrix, fiks	5
26	Zyrtar i Lartë për Fondin e Subjekteve Politike	Centrix, fiks	5
27	Zyrtar i Lartë Ligjor	Centrix, fiks	5
28	Zyrtar i Lartë për Informim dhe Edukim të Votuesve	Centrix, fiks	5
29	Zyrtar i Lartë për përkthim anglisht-shqip	Centrix, fiks	5
30	Zyrtar i Lartë për përkthim shqip-serbisht	Centrix, fiks	5
31	Zyrtar i Lartë për përkthim anglisht-serbisht	Centrix, fiks	5
32	Zyrtar i Lartë i Listës Votuese	Centrix, fiks	5
33	Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative	Centrix, fiks	5
34	Zyrtar i Lartë për Dizajn	Centrix, fiks	5
35	Zyrtar i Lartë i Bazës së të dhënave	Centrix, fiks	5
36	Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike	Centrix, fiks	5
37	Zyrtar i Lartë për Financa të Partive Politike	Centrix, fiks	5
38	Zyrtar i Lartë Ligjor	Centrix, fiks	5
39	Asistente e Kryeshefit Ekzekutiv	Centrix, fiks, mobil	20
40	Asistente e Kryetares së KQZ-së	Centrix, fiks, mobil	20
41	Zyrtar i Arkivit	Centrix, fiks	5
42	Zyrtar i Transportit	Centrix, fiks	5
43	Vozitës	Centrix, fiks	5

Shtojca II - Lartësia e lejuar e shpenzimeve të telefonisë mobile

Nr.	PËRSHKRIMI I POZITAVE	SHUMA
1	Kryetar i KQZ-së	50
2	Anëtar i KQZ-së	50
3	Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së	50
4	Zëvendës Kryeshef i SKQZ-së	40
5	Drejtor i ZRPPC	40
6	Drejtor i Auditimit	40
7	Drejtor i DAP-it	40
8	Drejtor i DOZ-it	40
9	Drejtor i Prokurimit	40
10	Drejtor i Departamentit për çështje ligjore	40
11	Drejtor i Departamentit për Teknologji Informativ	40
12	Zëdhënës i KQZ-së	30
13	Koordinator i ZLKZ-ve	30
14	Koordinator i QNR-së	30
15	Udhëheqës i Divizionit për Logjistik dhe Transport	20
16	Koordinator i Trajnimit	20
17	Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa	20
18	Udhëheqës i Divizionit për Personel dhe Shërbime të Përbashkëta	20
19	Udhëheqës i Divizionit për Informim dhe Komunikim me Publikun	20
20	Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin Votues	20
21	Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve	15
22	Zyrtar i Lartë për Komunikim me Mediat dhe Publikun	20
23	Zyrtar i Lartë Certifikues	10
24	Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa	10
25	Zyrtar i Lartë për Financa	10
26	Zyrtar i Lartë për Fondin e Subjekteve Politike	10
27	Zyrtar i Lartë Ligjor	10
28	Zyrtar i Lartë për Informim dhe Edukim të Votuesve	10
29	Zyrtar i Lartë për përkthim anglisht-shqip	10
30	Zyrtar i Lartë për përkthim shqip-serbisht	10
31	Zyrtar i Lartë për përkthim anglisht-serbisht	10
32	Zyrtar i Lartë i Listës Votuese	10
33	Zyrtar i Lartë për Teknologji Informativ	10
34	Zyrtar i Lartë për Dizajn	10
35	Zyrtar i Lartë i Bazës së të dhënave	10
36	Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike	10
37	Zyrtar i Lartë për Financa të Partive Politike	10
38	Zyrtar i Lartë Ligjor	10
39	Asistente e Kryeshefit Ekzekutiv	20
40	Asistente e Kryetares së KQZ-së	20
41	Zyrtar i Arkivit	10
42	Zyrtar i Transportit	15
43	Vozitës	15